

Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.805/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, duke u bazuar në Aktgjykimin A.nr.231/2021 të datës 09.11.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.719/2019 të datës 18.11.2019 të parashtruar nga ankuesja me adresë me adresë kundër organit të punësimit Komuna e Vitisë, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 08.12.2022, mori këtë;

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A. Nr.719/2019 e datës 18.11.2019, e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi Njoftimi me numër protokolli 02-016/01-880 i datës 21.08.2019 i Zyrës së Personelit në Komunën e Vitisë.

A r s y e t i m

Komuna e Vitisë me datën 17.07.2019, ka pranuar autorizimin për shpalljen e konkursit për pozitën "Zyrtar për Çështje Psikologjike" në Komunën e Vitisë nga Ministria e Administratës Publike, Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil. Komuna e Vitisë me datë 22.07.2019 ka shpallur konkursin për pozitën "Zyrtar për Çështje Psikologjike" në Çerdhen e fëmijëve „Gëzimi Ynë" në Komunën e Vitisë në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila ka marrë pjesë deri fazën e testit me shkrim sepse e njëjta nuk e ka kaluar testin me shkrim Komuna e Vitisë pas përfundimit të procedurave të rekrutimit më datë 21.08.2019 ka publikuar njoftimin për kandidaten e suksesshme. Ankuesja me datë 17.09.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Vitisë ndërsa sipas

përgjigjes nga Udhëheqësi i Personelit në Komunën e Vitisë e njëjta ka heshtur dhe nuk ka nxjerr vendim.

Ankuesja e pakënaqur me njoftimin e datës 21.08.2019, për për zgjedhjen përfundimtare të kandidatës, për pozitën "Zyrtar për Çështje Psikologjike" në Viti, me datë 18.11.2019, me numër protokoll 5408/2019 me ankesë i është drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me datë 19.11.2019 me numër protokoll 5440/2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Vitisë, ndërsa me datën 29.11.2019 me numër protokoll 5631/2019 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Vitisë me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri me datën 08.10.2020, ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa me datën 19.12.2019 me numër protokoll 5878/2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe e ka udhëzuar se mund të ndjek procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera, duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datën 03.09.2021 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.48/2020, i njëjti në Këshill është pranuar me datë 15.09.2021 sipas të cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses dhe ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 19.12.2019, duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 18.11.2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.10.2021 përmes Njoftimit me numër protokoll 4959/21 ka njoftuar ankuesen se nuk mund të vendos lidhur me ankesën A.Nr.805/2021 të datës 15.09.2021, për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, dhe ka udhëzuar të njëjtën mbi të drejtën e inicimit të procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Ankuesja përsëri ka ndjekur procedurat e tjera, duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative me datën 12.10.2022 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.231/2022, i njëjti në Këshill është pranuar me datë 09.11.2022 sipas të cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses dhe ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 19.12.2019, duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 18.11.2019.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 5408/2019 të datës 18.11.2019 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 19.11.2019; Përgjigje në ankesë me numër protokoli 5631/2019 e datës 29.11.2019; Konkurs Publik Drejtoria për Arsim i datës 22.07.2019; Autorizimi i Administratës Publike i datës 17.07.2019; Vendim për emërimin e antarve të komisionit për intervistim i datës 08.08.2019; Akt Emërim i F.D. me numër protokoli 10-112/2407 i datës 30.12.2011; Akt Emërim i R.O. me numër protokoli 02-112/03-1223 i datës 22.11.2018; Akt Emërim i A.M. me numër protokoli 02-112/03-484 i datës 06.05.2019; Akt Emërim i Z.S. me numër protokoli 11-112/2384 i datës 30.12.2011; Akt Emërim i E.Sh. me numër protokoli 05-112/2513 i datës 30.12.2011; Regjistri i Aplikacioneve të Pranuar; Përpilimi i listës së ngushtë i datës 16.08.2019; Kërkesa për punësim i kandidatës Shqipe Emiri e datës 29.07.2019; Diplomë e Sh.H. me numër nr. 15-764-04/2990 i datës 16.09.2011; Vendim nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për Sh.H. i datës 23.01.2018; Diplomë e Sh.H. me numër nr. protokoli 400 i datës 04.06.2003; Kontratë Pune nga kopshti i fëmijëve "Te Fjolla" e Sh.H. i datës 01.10.2016; Letër Referencë nga kopshti i fëmijëve "Te Fjolla" e Sh.H. e datës 11.03.2019; Rekomandim i datës 10.05.2019; Letërnjoftim i Sh.E.; Certifikatë Sh.E e datës 07.05.2019; Fletë për vlerësimin e kompetencës psikodiagnostike të stazhistit prej datës 01.07.2008 deri 31.07.2008; Certifikatë e martesës e Sh.H. e datës 02.05.2017; Pasqyra e llogarisë së trustit e Sh.H. e datës 01.08.2002 - 18.07.2019; Kërkesa për punësim i kandidatës Ardiana Rexhepi i datës 25.07.2019; Vërtetim i A.R. i datës 08.05.2019; Kontratë Pune e _____ e datës 01.11.2016; Vendim i A.R. i datës 24.06.2014; Certifikatë e A.R.e datës 06.05.2019; Certifikatë e A.R. e datës 20.05.2011; Certifikatë e A.R. e datës 02.07.2012; Vërtetim nga Qendra për punë sociale në Viti e A.R. i datës 21.12.2011; Letërnjoftim i A.R.; Pasqyra e llogarisë së trustit e A.R. e datës 01.08.2002 - 18.07.2019; Formulari MAP-SHCK-08a Vlerësimi Individual i Kandidatëve për Vendin e Punës për të cilin nuk Kërkohet Njohja e Ndonjë Gjuhe të Huaj i kandidatës _____ 1/5 faqe; Kërkesë për miratim e datës 20.08.2019; Renditja Përfundimtare e Kandidatëve; Përmbledhja e Vlerësimeve Individuale; Njoftimi i testit me shkrim i datës 19.08.2019; Njoftimi i datës 20.08.2019; Njoftim i datës 21.08.2019; Testi me Shkrim i kandidatës Shqipe Emiri i datës 19.08.2019; Testi me Shkrim i kandidatës _____ i datës 19.08.2019; Njoftim i datës 21.08.2019; Dëftesë për pranimin e dërgesës i datës 18.09.2019; Zarfi i Postës së Kosovës me nr. R7523493 i datës 14.11.2019; E-mail nga H.Y. për C.Z. i datës 06.12.2022; E-mail nga C.Z. për H.Y. i datës 06.12.2022; Ankesa e A.R. drejtuar Komisionit për ankesa dhe parashtrës në komunën e Vitisë; Fletëkthesë e datës 26.11.2019; Pliko me nr.R7524298 i datës 26.11.2019; Njoftim me numër protokoli 5878/2019 i datës 19.12.2019; Fletëkthesë e datës 28.12.2019; Pliko me nr.R8074727 i datës 28.12.2019; Fletëkthesë e datës 15.10.2021; Fletëkthesë e datës 12.10.2021; Njoftim me numër protokoli 4960/2021 i datës 08.10.2021; Njoftim me numër protokoli 4959/2021 i datës 08.10.2021; Aktgjykim me numër A.nr.48/2020 i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative i datës 03.09.2021 i njëjti në Këshill është pranuar me datë 15.09.2021; Kërkesë nga A.R. për dhënien e vendimit shqyrtimit të ankesës me numër protokoli 6444/2021 i datës 30.12.2021; Pliko me nr.R1943672 i datës 28.12.2021; Aktgjykim me numër A.nr.231/2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative i datës 12.10.2022 i njëjti në Këshill është pranuar me datë 09.11.2022; Dëftesë për pranimin e dërgesës e datës 17.09.2019; Pliko me nr.R7523493 i datës 14.11.2019;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pa bazuar sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se në konkursin e shpallur të datës 22.07.2019 nga Komuna e Vitisë, për pozitën "Zyrtar për Çështje Psikologjike" kriteret e konkursit kanë qenë:

- *Diplomë Universitare; Fakullteti i Psikologjisë*
- *Dy (2) vite përvojë pune profesionale*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të shkresave të lëndës të dorëzuara nga ankuesja, si dhe organi i punësimit ka konstatuar që procedura e rekrutimit për pozitën "Zyrtar për Çështje Psikologjike" e shpallur me datë 22.07.2019 dhe e vazhduar edhe për 7 dite nga Komuna e Vitisë, është bërë në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, ku është përcaktuar se: "*Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mosdiskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës*", me rastin e shpalljes së konkursit publik, të datës 22.07.2019, pasi ka marrë autorizimin nga Ministria e Administratës Publike DASHC/MAP me datën 17.07.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankueses kundër përzgjedhjes së kandidatës së suksesshëm të datës 21.08.2019 për pozitën "Zyrtar për Çështje Psikologjike", është i paqëndrueshëm sepse ankuesja është përfshirë në listën e ngushtë me datë 16.08.2019 dhe komisioni përzgjedhës e ka vlerësuar drejtë në pajtim me nenin 28 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 neni 2, 3, 4 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil ku thuhet: "*Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijim:...,1.2. përvojën e punës, secili anëtar vlerëson kandidatin në secilin kriter. Numri maksimal i secilit kriter është 20 pikë. Numri maksimal është 80, ndërsa minimumi për vazhdimin e kandidatit në procedura të tjera është 40 pikë. Kandidatet, të cilët nuk arrijnë numrin minimal të pikëve përjashtohet nga fazat e tjera të përzgjedhjes*".

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, po ashtu ka konstatuar që testi me shkrim është përgatitur në pajtim me kriteret e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, 1.2 dhe 1.3 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, që përcakton se: "*Testimi me shkrim për kandidatët përmban 30 deri 50 pyetje, ndërsa përbëhet prej katër pjesëve: Pjesa e njohurive të përgjithshme, ku përcaktohet se: „Në këtë pjesë, kandidatëve u parashtrihen 3 deri në 5 pyetje në formë eseje nga 150 deri 250 fjalë...“; Pjesa e aftësive të përgjithshme dhe të personalitetit, ku përcaktohet se: „Në këtë pjesë kandidatëve u parashtrihen 10 deri në 15 pyetje me përgjigje të shumëfishta, të cilat kanë për qëllim testimin e kapacitetit intelektual për të menduar dhe arsyetuara në mënyrë logjike dhe analitike...“; Pjesa e njohurive që lidhen me vendin e punës, ku përcaktohet se: „Në këtë pjesë kandidatëve u parashtrihen 15 deri 23 pyetje, të cilat janë 50% me përgjigje të shumëfishta dhe 50% në formë eseje*".

Ndërsa lidhur me pretendimet ankimore të ankueses për rezultatet e testit me shkrim Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit gjegjësisht gjatë vlerësimit të testit me shkrim si për ankuesen, po ashtu edhe për kandidaten e përzgjedhur, ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 36 paragrafin 3, nenin 37 si dhe nenin 39 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në

Shërbimin Civil, sepse në bazë të vlerësimeve kandidatja e përzgjedhur ka arritë gjithsejtë 87 pike pikë nga testi me shkrim, ndërsa ankuesja ka arritë gjithsejtë 19 pikë nga testi me shkrim, gjegjesisht ankuesja nuk ka arritur pikët minimale mbi 50 %, për të vazhduar në fazën e intervistës me gojë andaj Kolegji konstaton se Komisioni Përzgjedhës për Shërbimin Civil, me rastin e përjashtimit të ankuese nga fazat e tjera të konkurrimit ka vepruar në pajtim me nenin 36 paragrafin 3 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, po ashtu konstaton se përzgjedhja e kandidatës është bërë në pajtim edhe me dispozitat e nenit 40 paragrafi 1 dhe paragrafi 3 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *“Në shërbimin civil emërohen kandidatët të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë”, “Kandidat i suksesshëm konsiderohet ai, i cili në testin e përgjithshëm (testin me shkrim dhe me gojë) ka jo më pakë se 60% të maksimumit të pikëve të caktuara”,* në rastin konkret konkursi është shpallur për një (1) pozitë dhe në bazë të Formulari Form. MAP/SHCK-10 për renditjen përfundimtare të kandidatëve, kandidatja e përzgjedhur ka arritë gjithsejtë 86.7 pikët e përgjithshme nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, ndërsa ankuesja pas vlerësimit të testit me shkrim, nuk ka arritur të kalojë testin me shkrim jегjesisht ka arritë gjithsejtë 19 nga pikët e përgjithshme, dhe e njejeta nuk është ftuar për interviste me gojë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka shqyrtuar edhe pretendimin e ankuses se komisioni përzgjedhës nuk i ka bërë vlerësimin real të përvojës së punës në krahasim me kandidaten e përzgjedhur, ky pretendim nuk është i qëndrueshëm sepse kandidatja e përzgjedhur ka përvojë të punës të kërkuar në pajtim me kriteret e konkursit të datës 22.07.2019 siç është kërkuar *„Diplomë Universitare; Fakulteti i Psikologjisë si dhe Dy (2) vite përvojë pune profesionale,* sepse kandidatja e përzgjedhur në vendin e punës *“Zyrtar për Çështje Psikologjike”*

posedon Diplome me numër 15-764-04/2990 të datës 16.09.2011 të lëshuar nga Universiteti Shtetëror i Tetovës me të cilën dëshmohet se ka përfunduar Fakultetin Filozofik në drejtimin Psikologji dhe më datë 27.12.2010 mori titullin *„Psikolog i diplomuar”,* e nostrifikuar me Vendimin e datës 23.01.2018 të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, si dhe me përvojë të punës sipas Vërtetimit të datës 11.03.2019 të lëshuar nga Kopshti *„Te Fjolla”* në Gjilan e punësuar nga data 03.10.2016 deri me datën 28.02.2019 në pozitën *„Psikologe”,* të cilën e dëshmon edhe me Pasqyrën e llogarisë nga Trusti Pensional i Kosovës, si dhe Rekomandimin e lëshuar nga Qendra për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve *“Liria”* Strehimorja në Gjilan, me të cilin dëshmohet se kandidatja e përzgjedhur ka punuar si praktikante nga viti 2015, andaj Kolegji konstaton se në bazë të dëshmive të ofruara konkretisht në bazë të trustit pensional kandidatja e përzgjedhur ka mbi dy vite përvojë pune profesionale pas diplomimit ashtu siç është kërkuar në konkursin e datës 22.07.2019 *„Diplomë Universitare; Fakulteti i Psikologjisë si dhe Dy (2) vite përvojë pune profesionale,*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha dëshmive për përgatitjen profesionale dhe përvojës së punës të bashkangjitura në dosjen e kandidatës të përzgjedhur dhe të ankuses, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës për Shërbimin Civil, ka vlerësuar drejtë me rastin e përzgjedhjes përfundimtare të kandidatës së suksesshëme për pozitën *“Zyrtar për Çështje Psikologjike”* në Komunën e Vitisë, duke u bazuar në nenin 2 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së

Kosovës, ku përcakton se: „*Merita-veçantia e cila krijon të drejtën e punësimit të një kandidati në një pozitë në shërbimin civil pas përfundimit të suksesshëm të procedurës konkurruese të përzgjedhjes*”, sepse kandidatja e përzgjedhur i ka përmbushur kriteret e veçanta dhe të përgjithshme të kërkuara në konkursin e shpallur me datë 22.07.2019, për pozitën “Zyrtar për Çështje Psikologjike” në Viti.


Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se procedura e rekrutimit nga Komuna e Vitisë, është bërë në pajtim edhe me nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: “*Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës*”, po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komuna e Vitisë, lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit dhe përzgjedhjes se kandidatës për pozitën “Zyrtar për Çështje Psikologjike” në Komunën e Vitisë, ka vepruar në pajtim me nenin 11 paragrafit 1 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcakton se: „*Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve.*”

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

*Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A. Nr. 805/2021*

Çlirim Zeka


Procesmbajtës

Malsore Gashi Bajraktari

Kryetare e kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Vitisë;
- Drejtorit të Drejtoratit për Arsimit në Komunën e Vitisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Vitisë si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së